

**R E L A C I O N**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN**  
**“PËR INTELIGJENCËN ARTIFICIALE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektligj ka për qëllim krijimin e kuadrit ligjor për zhvillimin, vendosjen në treg, vënien në shërbim dhe përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale (IA) në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet e sigurisë, mbrojtjes së të drejtave themelore, shtetit të së drejtës, transparencës dhe inovacionit teknologjik.

Projektligji synon:

- garantimin e përdorimit të besueshëm dhe të sigurt të sistemeve të IA-së;
- mbrojtjen e shëndetit, sigurisë, të drejtave themelore dhe të dhënave personale;
- vendosjen e rregullave për sistemet e IA-së me rrezik të lartë;
- ndalimin e praktikave të papranueshme të IA-së;
- krijimin e mekanizmave të mbikëqyrjes së tregut dhe kontrollit institucional;
- përcaktimin e kërkesave për transparencë, dokumentim teknik dhe mbikëqyrje njerëzore;
- promovimin e inovacionit, zhvillimit teknologjik dhe sandbox-eve rregullatore;
- përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e inteligjencës artificiale.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

“Projektligji është hartuar në përputhje me strukturën dhe parimet e Rregullores (BE) 2024/1689 (AI Act) dhe është i organizuar në 9 krerë, disa seksione tematike, 106 nene dhe 13 anekse, të cilat rregullojnë në mënyrë të plotë zhvillimin, vendosjen

në treg, përdorimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e sistemeve të inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë.”

Projektligji është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave për transformimin digjital, Strategjinë Kombëtare për Qeverisjen Elektronike dhe Agjendën Digjitale, si dhe me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integritit evropian.

Ky projektligj lidhet drejtpërdrejt me përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Kapitulli 10 “Transformimi Digjital dhe Media”, si dhe me procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e inteligjencës artificiale.

Projektligji është pjesë e masave prioritare për krijimin e një kuadri të sigurt dhe të besueshëm për përdorimin e inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME**

Zhvillimi i shpejtë i sistemeve të inteligjencës artificiale ka krijuar nevojën për një kuadër të posaçëm ligjor që garanton përdorimin e sigurt, transparent dhe të përgjegjshëm të këtyre teknologjive.

Mungesa e një kuadri të dedikuar ligjor për IA-në krijon pasiguri juridike për operatorët ekonomikë dhe institucionet publike, mungesë standardesh për sigurinë dhe transparencën e sistemeve IA, si dhe rrezik për cenimin e të drejtave themelore dhe të dhënave personale.

Projektligji parashikon:

- klasifikimin e sistemeve të IA-së sipas nivelit të rrezikut;
- kërkesa të posaçme për sistemet me rrezik të lartë;
- detyrime për ofruesit, përdoruesit, importuesit dhe shpërndarësit;
- mekanizma të mbikëqyrjes së tregut dhe vlerësimit të konformitetit;
- krijimin e sandbox-eve rregullatore për inovacionin;
- masa administrative dhe mekanizma kontrolli;
- bashkëpunim institucional ndërmjet autoriteteve kompetente.

Efektet e pritshme të projektligjit janë:

- rritja e sigurisë juridike dhe teknike në përdorimin e IA-së;

- mbrojtja më efektive e qytetarëve dhe konsumatorëve;
- harmonizimi me standardet e Bashkimit Evropian;
- nxitja e inovacionit dhe investimeve në teknologji;
- forcimi i mbikëqyrjes institucionale dhe mbrojtjes së të drejtave themelore.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji është në përputhje me:

- legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- legjislacionin për qeverisjen elektronike;
- legjislacionin për mbikëqyrjen e tregut;
- legjislacionin për sigurinë e produkteve;
- legjislacionin procedural penal;
- legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit;
- legjislacionin për sigurinë kibernetike dhe infrastrukturën kritike.

Projektligji respekton parimet kushtetuese të proporcionalitetit, sigurisë juridike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Ky projektligj synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me Rregulloren (BE) 2024/1689 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për Inteligjencën Artificiale” (Artificial Intelligence Act), si dhe me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e mbikëqyrjes së tregut, sigurisë së produkteve, mbrojtjes së konsumatorit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Projektligji është hartuar mbi strukturën dhe parimet e AI Act të Bashkimit Evropian, duke u përshtatur me rendin juridik dhe organizimin institucional të Republikës së Shqipërisë.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përbëhet nga dispozita që rregullojnë:

- qëllimin, objektin dhe fushën e zbatimit;
- përkufizimet kryesore të inteligjencës artificiale;
- praktikat e ndaluara të inteligjencës artificiale;
- klasifikimin e sistemeve të IA-së me rrezik të lartë;
- kërkesat teknike dhe organizative për sistemet me rrezik të lartë;
- sistemin e menaxhimit të rrezikut;
- qeverisjen dhe cilësinë e të dhënave;
- dokumentacionin teknik;
- regjistrimin dhe transparencën;
- mbikëqyrjen njerëzore;
- vlerësimin e konformitetit;
- monitorimin pas vendosjes në treg;
- sandbox-et rregullatore për IA;
- kompetencat e autoriteteve përgjegjëse;
- masat administrative dhe sanksionet;
- bashkëpunimin ndërinstitucional;
- dispozitat kalimtare dhe hyrjen në fuqi.

Projektligji përcakton gjithashtu:

- Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si autoritet koordinues/Strukturë për IA-në;
- autoritetin përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut;
- autoritetin njoftues;
- Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

si autoritete kompetente për zbatimin e këtij ligji.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë:

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut;
- autoriteti njoftues;
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- institucionet dhe autoritetet e tjera kompetente sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse sipas fushave përkatëse dhe në konsultim me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e inteligjencës artificiale dhe acquis të Bashkimit Evropian.

Projektligji është hartuar duke marrë në konsideratë standardet dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian, rekomandimet ndërkombëtare në fushën e inteligjencës artificiale, si dhe nevojat për zhvillimin e sigurt dhe të besueshëm të teknologjive të inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji do t'u dërgohet për mendim institucioneve përgjegjëse nëpërmjet sistemit e-aktet, në përputhje me procedurat e përcaktuara për bashkërendimin institucional të projektakteve normative.